REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.106.Datë 24.12.2025

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË HAS PËR VITIN 2026.

Këshilli në mbledhjes e dates së mësipërme,bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

VENDOSI

15 VOTA PRO

1 KUNDRA

1 ABSTENIM

1.Të miratojë sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2026 me ndryshime.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore," të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Isuf SEFOLLI

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Nr. 167 Prot
Dt. 14.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 1/3 prot. Kukës më, 13.01.2026

L Ë N D A : **Verifikimi i Ligjshmërisë së *Aktit.***
KRYETARIT TË BASHKISË
KËSHILLIT BASHKIAK

HAS

Në protokollin e Prefektit të Qarkut Kukës është regjistruar vendimi nr.106 datë 24.12.2025 i këshillit bashkiak Has me nr. protokolli 4730 datë 29.12.2025, protokolluar me tonën me nr.01 datë 05.01.2026.

Bazuar në ligjin nr.107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*" (*i ndryshuar*) neni 16, shqyrtuam vendimin nr.106 datë 24.12.2025 "Për miratimin e sistemimit të taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Has për vitin 2026", si dhe dokumentacionin ploteësues.

Ky vendim **është në përputhje** me ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (*i ndryshuar*) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja b), neni 35, neni 36, neni 54 pika 1 shkronja f); ligjin nr.6932 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (*i ndryshuar*), ligjin nr.8485 datë 12.05.1999 " Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (*i ndryshuar*), ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë; ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (*i ndryshuar*); VKM-në nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" *(e ndryshuar)*.

Shënim: Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" është shfuqizuar me ligjin nr.57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 64, shkronja "b", zbatimi i akteve të këshillit bashkiak është detyrë dhe kompetencë e kryetarit të bashkisë dhe jo siç jeni shprehur në pikën 2 të këtij vendimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

PREFEKTI
Dritan Baji

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Adresa: Sheshi "Skënderbej" ; Nr. cel +355683363010; Email: prefekti.kukes@mb.gov.al; http://prefekturakukes.gov.al/

PAKETA FISKALE E BASHKISË HAS

VITI 2026

I. Hyrje

Bashkia Has shtrihet në veriun e Republikës së Shqipërisë, në një territor me karakteristika të veçanta gjeografike, kufitare dhe socio-ekonomike. Pozicioni i saj gjeografik varion nga gjerësia gjeografike veriore 42° 05' 45" në zonën e fshatit Brrut deri në 42° 17' 57" në majën e Krajlicës, ndërsa gjatësia gjeografike lindore shtrihet nga 20° 13' 11" në zonën e Kosturrit deri në 20° 32' 50" në majën e Pashtrikut. Territori i Bashkisë ka një sipërfaqe prej 393 km², duke përfshirë një vijë kufitare prej 85.8 km, nga të cilat 27.8 km janë kufij tokësorë me Hasin e Rrafshit, 14 km janë kufij lumorë me rrethin e Tropojës dhe 44 km kufij liqenorë me rrethin e Hasit. Qendra administrative e Bashkisë është Kryeqyteti Krumë, i shpallur qytet në vitin 1972. Sipas Ligjit Nr.115/2014 "Për ndarjen administrativo–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, territori i Bashkisë Has përbëhet nga katër njësi administrative, të cilat përfshijnë ish-komunat para reformës territoriale të vitit 2015. Njësia Administrative Krumë përfaqëson zonën urbane që më parë kishte statusin e Bashkisë Krumë, ndërsa njësitë e tjera përbëhen nga fshatra me histori, traditë dhe veçori ekonomike të rëndësishme.

Struktura administrative e Bashkisë Has është si më poshtë:

- Njësia Administrative Golaj: Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrune, Zgjeç, Qarr, Helshan, Kosturr.
- Njësia Administrative Krumë: Krumë, Gajrep, Cahan, Mujaj–Dajç, Zahrisht.
- Njësia Administrative Gjinaj: Gjinaj, Pusi i Thatë, Myç–Has, Domaj, Pogaj, Kishaj.
- Njësia Administrative Fajzë: Fajzë, Vranisht, Tregtan, Liqeni i Kuq, Metaliaj, Brenogë, Tobël, Sefoll.

Bashkia Has karakterizohet nga një terren kryesisht malor dhe kodrinor, një pozicion strategjik kufitar dhe një identitet social e kulturor të konsoliduar. Këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, bujqësor, turistik dhe fiskal të zonës, duke përcaktuar nevojën për një paketë të qëndrueshme fiskale që reflekton realitetet lokale, burimet e disponueshme dhe objektivat afatgjata të zhvillimit. Paketa Fiskale 2026 synon të ndërtojë një sistem të drejtë, të balancuar dhe nxitës taksash e tarifash vendore, i cili mbështet zhvillimin ekonomik, fuqizon financat vendore dhe garanton shërbime publike cilësore për të gjithë qytetarët dhe komunitetet e Bashkisë Has.

Në përputhje me organizimin administrativ dhe urbanistik në territorin e Bashkisë Has, për të ndarë proporcionalisht nivelin e taksave dhe tarifave që aplikon Bashkia ndaj subjekteve të ndryshëm, krijohen këto zona fiskale:

1. Zona "A": Qyteti Krumë.

2. Zona "B": Njësitë Administrative Golaj, Fajza, Gjinaj dhe fshatrat e Njësisë Administrative Krumë.

II. BAZA LIGJORE

Paketa Fiskale 2026 e Bashkisë Has hartohet dhe zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë, i cili rregullon funksionimin e vetëqeverisjes vendore, administrimin e taksave dhe tarifave vendore, menaxhimin e financave publike, si dhe sektorë të tjerë të lidhur me ushtrimin e kompetencave të bashkisë.Për hartimin e Paketës Fiskale 2026 janë konsultuar aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

a) Ligje

- Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar
- Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
- Ligji Nr.131/2015, datë 26.11.2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
- Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- Ligji Nr.93/2015, "Për turizmin".
- Ligji Nr.9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.
- Ligji Nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
- Ligji Nr.111/2018, "Për Kadastrën".
- Ligji Nr.10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar".
- Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin dhe tregtimin e naftës e nënprodukteve të saj", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10279, datë 20.5.2010, "Për kundravajtjet administrative".
- Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit te njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.
- Ligji Nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
- Ligji Nr.9789, datë 19.7.2007, "Për zonat ekonomike".
- Ligji Nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

b) Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

- VKM Nr.783, datë 10.11.2011 – Procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës së mjeteve të përdorura.
- VKM Nr.7, datë 4.01.2012 – Për procedurat dhe dokumentacionin e taksës së rentës minerare.
- VKM Nr.970, datë 02.12.2015 – Për licencat e tregtimit të naftës dhe nënprodukteve.
- VKM Nr.396, datë 21.6.2006 – Për transferimin dhe përdorimin e pyjeve.
- VKM Nr.391, datë 21.6.2006 – Për tarifat e pyjeve dhe kullotave (i ndryshuar).
- VKM Nr.632, datë 11.06.2009 – Tarifat për kullotat.
- VKM Nr.1064, datë 22.12.2010 – Ndryshime në tarifat e pyjeve/kullotave.
- VKM Nr.54, datë 05.02.2014 – Përdorimi dhe dhënia me qira e pasurive shtetërore (i ndryshuar).
- VKM Nr.992, datë 9.12.2015 – Ndryshime në VKM nr.54/2014.
- VKM Nr.469, datë 3.6.2015 – Vlera minimale e qirasë së ndërtesave për qëllime tatimore.
- VKM Nr.575, datë 24.6.2015 – Menaxhimi i mbetjeve inerte.
- VKM Nr.285, datë 27.6.2002 – Tarifat e shërbimeve të zjarrfikëses.
- VKM Nr.1108, datë 30.12.2015 – Transferimi i sistemeve të ujitjes/kullimit te bashkitë.
- VKM Nr.666, datë 10.10.2019 – Kuotat financiare në arsimin parauniversitar.
- VKM Nr.323, datë 14.6.1993 – Kalimi i çerdheve në administrim vendor.
- VKM Nr. 132, datë 7.3.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar".
- VKM Nr.783, datë 10.11.2011 – Për të ardhurat nga taksa vjetore e mjeteve (përsëritje e nevojshme ligjore).

c) Udhëzime dhe Akte të Ministrive

- Udhëzimi Nr.1, datë 12.1.2007 – Për veprimtaritë tregtare ambulante.
- Udhëzimi Nr.32, datë 31.12.2013 – Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël.
- Udhëzimi Nr.26, datë 4.09.2008 – Për taksat kombëtare.
- Udhëzimi i Përbashkët Nr.655/1, datë 06.02.2007 – Për sistemin e taksës vendore.
- Udhëzimi Nr.6756, datë 3.9.2015 – Për zbatimin e VKM nr.54/2014.
- Udhëzimi Nr.30, datë 27.12.2011 – Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.
- Udhëzuesi Nr.541/1, datë 31.12.2015 – Për transferimin e ujitjes dhe kullimit te bashkitë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Kreu I:

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Has, nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, lehtësimit apo përjashtimit, arkëtimit dhe transferimit në buxhetin e bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

Neni 2

Llojet e taksave

Në Bashkinë Has aplikohen këto taksa vendore:

a. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin;
b. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
c. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
e. Taksa e fjetjes në hotel;
f. Taksa e tabelës;
Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim apo në aktet ligjore dhe nënligjore të veçanta.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të taksës së ndërtimit në Bashkinë Has, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjenti i mbledhjes së taksave dhe tarifave" është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Has apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.

2. "Pasuri e paluajtshme" janë trualli, toka bujqësore dhe ndërt esat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

3. "Kadastra fiskale" është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

4. "Sektori i Taksave dhe Tarifave " është struktura për administrimin e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Has.

5. "Niveli tregues i taksës" janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.

6. "Çmimi vlerësues", njësi matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

7. "Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nenë sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfshijnë një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtimin sipas përcaktimit të dhënë në këtë vendim.

8. "Ndërtesë e papërfunduar", objekti që ndodhet në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, e cila ndodhet në fazën "fundi i shtyllave" të ndërtimit, por që nuk ka arritur të përfundojë atë sipas afatit përkatës të përcaktuar në lejen e ndërtimit ose për leje ndërtimi.

9. "Njesi pronësore" nënnjësia e një ndërtese që përbën një tërësi të pavarur të ndërtimit të ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme (ndërtesës). Në të përfshihen objektet e përcaktuara për qëllim banimi ose/edhe për qëllim shërbimi."Tarifë vendore":çdo pagesë që vendoset si kompensim për shërbime, autorizime, leje, përdorim pronash, tabela, reklamime, etj., dhe që administrohet nga Bashkia Has sipas këtij vendimi.

10. "Ndarje e njësisë pronësore për banim" është pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllime banimi.

11. "Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike" është pjesa e njësisë pronësore që përdoret për veprimtari ekonomike.

12. "Përdorues" është individi, personi fizik ose juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtari ekonomike ose për veprimtari jokomerciale, pavarësisht nëse ai/ajo është apo jo titullar i pronësisë.

13. "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Has, që paguhet nga çdo person apo subjekt për ushtrimin e një të drejte publike apo përfitimin e një shërbimi publik në territorin e Bashkisë Has.

14. "Tarifë" është pagesa që një individ, person fizik apo juridik, bëhet drejtpërdrejt ndaj një shërbimi të ofruar nga administrata e Bashkisë Has. Pagesa kryhet në këmbim të një shërbimi specifik të marrë, një të mire publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.

15. "Taksa pagues" është individi, personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë një taksë vendore të përcaktuar me vendim të organeve përkatëse të Bashkisë Has në zbatim të legjislacionit në fuqi.

16. "Vlera e pasurisë" është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësisë pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

17. "Veprimtari ekonomike" është çdo veprimtari e kryer nga personat juridikë, personat e vetëpunësuar ose personat fizikë me qëllim prodhimi, tregtarie, shërbimesh ndaj të tretëve, përfshirë veprimtari bujqësore, industriale, tregtare, shërbimi apo profesionale.

Veprimtari ekonomike konsiderohet çdo shfrytëzim i pasurisë së paluajtshme që sjell të ardhura të vazhdueshme.

KREU II
TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët: lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Neni 4
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Neni 5

Taksa mbi Ndërtesat

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.".

Bazuar në VKM Nr.132, datë 07.03.2018, neni 2, pika 3, paragrafi i parë, në të cilin parashikohet se: "Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nën ndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind",miratohen ndryshimet e niveleve të taksës sipas zonave si më poshtë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Tabela 1: Shkalla e taksës e miratuar

Njësia Administrative/ Zona fiskale	Shkalla e taksës për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret/shfrytëzohet për:						
	Banimi			Veprimtari ekonomike			
	Shkalla e taksës sipas VKM Nr.132	Ndryshimi i shkallës së taksës e miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	Shkalla e taksës sipas VKM Nr.132	Ndryshimi i shkallës së taksës e miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	
Bashkia Krumë	0.05%	-30%	0.035 %	0.2%	-	0.2%	
Njësitë Administrative dhe fshatrat CAHAN,MUJAJ,KISHAJ,ZAHRISHT,GAJREP,KRUMË	0.05%	-30%	0.035 %	0.2%	-30%	0.14%	

Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë,sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi aplikohet 30% e shkallës së taksës përkatëse. Në VKM Nr.132 datë 7.3.2018, neni 2, pika 3, paragrafi i dytë parashikon se: "Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimine zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale...". Bazuar në sa më sipër miratohen reduktimet e çmimeve referuese si më poshtë:

Miratimin e çmimit mesatar referues për vitin 2026 të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi sipas tabelës nr. 3, më poshtë.

Tabela nr. 2. Çmimi mesatar referues të banesave për vitin 2026

Qyteti		Lekë/ m2 sipërfaqe shfrytëzimi	Njësitë Administrative nënzonat e Bashkisë Has		Lekë/ m2 sipërfaqe shfrytëzimi
1	KRUMË	24,500 Lekë	1	Njësia Administrative GOLAJ	15,925 Lekë
			2	Njësia Administrative FAJZA	
			3	Njësia Administrative GJINAJ	
			4	Fshatrat: CAHAN; MUJAJ; KISHAJ; ZAHRISHT; GAJREP; KRUMË.	

Koefiçentët e aplikuar mbi çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimi.

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesat tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose /edhe shërbime me pakicë.

2 Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

e) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

1. Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të bashkive;
5. pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga Bashkia si banesa sociale;
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
8. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.

Për llogaritjen, gjenerimin dhe administrimin e taksës mbi ndërtesat, përgjegjëse është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Has. Ky sektor kryen verifikimin e të dhënave mbi sipërfaqet, funksionin e përdorimit të ndërtesave (banim ose veprimtari ekonomike), si dhe përditësimin e regjistrit tatimor.

Pagesa e taksës mbi ndërtesat kryhet Brenda datës 30 qershor. Për ndërtesat e reja të deklaruara gjatë vitit, afati i pagesës është 30 ditë nga data e gjenerimit të faturës.

Neni 6

Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi, në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabela 3. Niveli I taksës mbi tokën bujqësore

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore Sipas ligjit	Propozimi
VII – X	lekë/ha/vit	1,400	700

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor.

Përjashtohen nga pagesa e taksës bujqësore:

Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Për llogaritjen, gjenerimin dhe administrimin e taksës, përgjegjëse është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Has. Pagesa e taksës kryhet Brenda datës 30 qershor.



Neni 7

Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i takses se truallit ne leke per meter katror ne vit

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin
Vlera e taksës se truallit per qëllime banimi nga individet	lekë/m²/vit	0.14
Vlera e taksës se truallit per qëllime biznesi	lekë/m²/vit	12

Taksimi mbi truallin është detyrim vjetor. Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore kryen llogaritjen e shumës së detyrimit në bazë të sipërfaqes së truallit dhe vlerës së taksës, sipas tabelës referuese dhe klasifikimit të miratuar.

Neni 8

Taksa e fjetjes në hotel

Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

Detyrimi për taksën e fjetjes në hotel llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës së miratuar nga bashkia, për çdo natë qëndrimi, me numrin e netëve që klienti ka qëndruar në strukturën akomoduese.

Detyrimi për taksën i përket klientit që akomodohet në hotel, ndërsa subjekti (hoteli) ka detyrimin ta mbledhë atë për llogari të bashkisë përkatëse ku ushtron aktivitetin. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës së fjetjes, e cila i faturohet klientit. Subjekti akomodues ka detyrimin ta derdhë shumën e mbledhur në llogari të bashkisë brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Struktura përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e taksës së fjetjes në hotel, për të gjitha kategoritë e subjekteve akomoduese, është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë.

Neni 9

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Tabela 6: Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për vitin 2026

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Në % të çmimit të shitjes për m2.
1.	Për leje ndërtimi për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.	6% të çmimit të shitjes për Biznes dhe 4% e çmimit të shitjes për shtëpi banimi
2.	Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në piken 1, më lart.	1% të vlerës së investimit
3.	Leje ndërtimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1 %
4.	Për ndërtesat, të cilat janë në proçes legalizimi	0.5 %

Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksa per çdo rast mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet për çdo rast për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do të kryhet investimi.

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/ Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Sektori i Taksave dhe Tarifave.

Neni 10

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 7. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Has
Ndërtesa banimi	Lekë/m2	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m2	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m2	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë tre për qind (3 %) të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Neni 11

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Baza e taksës: Është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, njëzetë e pesë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Has në llogarinë e degës së thesarit.

Neni 12

Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, pesë për qind (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Has në llogarinë e degës së thesarit.

Neni 13

Taksa e Tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi. Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë qofshin këto publike ose private.



Tabelë 8. Taksa e tabelës

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashkia Has
I	Taksë tabele për qellime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	deri në 2 m2	leké/m2/vit	0
b	•mbi 2 m2 deri 10 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	7,000

	•me ndriçim të thjeshtë	leké/m2/vit	11,500
	•elektronike	leké/m2/vit	15 000
c	mbi 10 m2 deri 20 m2		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	léké/m2/vit	9 775
	-elektronike	leké/m2/vit	12 750
Ç	mbi 20 m2 deri 40 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	leke/m2/vit	3 850
	•me ndriçim të thjeshtë	leké/m2/vit	6 325
	-elektronike	leké/m2/vit	8 250
d	mbi 40 m2		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	2,800
	-me ndriçim të thjeshtë	leke/m2/vit	4 600
	•elektronike	leké/m2/vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	-Tabela identifikuese	leké/m2/vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	•e thjeshtë (me/pa ndriçim)	leké/m2/vit	13 500
	-Elektronike	leké/m2/vit	27 000
IV.	Tabela ne funskion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	leké/m2/ditë	1,000

Për të gjitha tabelat për qëllime identifikimi apo reklamimi të cilat ndodhen jashtë territorit të objektit ku zhvillohet aktiviteti, subjekti paraqet kërkesë me shkrim pranë drejtorisë përkatese, e cila pasi shqyrton kërkesën e subjektit për leje, vendos për dhënien e saj ose jo. Në lejen e lëshuar detyrimisht përcaktohen vendi i ndodhjes, lloji i tabelës, përmasat etj.

Një kopje e lejes së lëshuar dorëzohet në Sektorin e Taksave dhe Tarifave. Kjo e fundit përllogarit dhe ndjek arkëtimin e taksës së reklamës/ tabelës për vitin kalendarik nga muaji koherent i vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Sektori i Urbanistikës

Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.



Kreu III:

Tarifat Vendore

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët: Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Bashkia Has aplikon tarifat vendore si më poshtë:

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

b. Tarifa e parkimit të automjeteve;

c. Tarifa për zënien e hapësirave publike;

d. Tarifa për dhënien e licencës për tregtim karburanti dhe lëndë djegëse;

e. Tarifa e shërbimit veterinar;

Neni 14

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/ janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Has dhe njësive të saj administrative.

Tabela 9: Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet, personat fizikë dhe juridikë per vitin 2026 në lekë/vit

Nr	Emërtimi i subjektit	2025	2026
1	**Familjarët (për familje)**	1.000	1.200
2	**Shitoret për fruta, perime, ushqimore, bulmetore me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	9.500	9.500
	b. mbi 50 m²	12.500	12.500
3	**Shitoret për mish, peshk me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	10.500	10.500
	b. mbi 50 m²	13.000	13.000
4	**Lokalet bar-bufe, restorante me sipërfaqe lokali:**		
	a. deri në 50m²	11.000	11.000
	b. mbi 50 m²	13.000	13.000
5	**Shitoret e artikujve të përzier dhe industrialë me sipërfaqe lokali:**		
	a. deri në 50m²	12.000	12.000
	b. mbi 50 m²	12.500	12.500
6	**Institucionet social kulturore private për çdo njësi të liçencuar.**	13.000	13.000
7	**Njësi shërbimi, riparime, punime artizanale, rrobaqepësi, servise, lavazhe, parkingje, bilardo, fotograf të biznesit të vogël.**	5.500	5.500
8	**Njësi shërbimi e riparimi (teneqepunues, zdrukthtari, radio, riparim telefonash, berber,floktore, taksi etj).**	6.500	6.500
9	**Shërbimet e specializuara:**	14.000	14.000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

	Dentist, farmaci, farmaci bujqësore, radiolog,sherbime interneti,ekografist, laborator,biznes i vogel		
10	**Shërbimetë tjera si: Avokat, noter, kancelarie,fotokopje, librari, shtypshkronjë,kafe internet, Njësi transferta parash apo këmbime valutore.**	6.000	6.000
11	**Njësi prodhimi (druri, duralumini, parafabrikate ndërtimi, furra buke, ëmbëltore, byrektore etj.)**	9.000	9.000
12	**Biznesi i vogël që klasifikohet me T.V.SH**	17.000	17.000
13	**Të gjithë personat juridikë të biznesit të madh, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.**	40.000	40.000
14	**Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.**	40.000	40.000
15	**Firmat e tregtimit të karburanteve dhe të gazit.**	45.000	45.000
16	**Kompanitë celulare apo të komunikimeve elektronike dhe të lidhura me to.**	50.000	50.000
17	**Subjektet me aktivitet minerar dhe hidrocentralet pamvarësisht zonës A apo B.**	120.000	120.000
18	**Subjektet me aktivitet në fushën e inerteve (guroret) dhe fabrikat pamvarësisht zonës A apo B.**	50.000	50.000
19	**Institucionet social kulturore dhe shtetërore që përdorin Pallatin e Kultures.**	5.000 Çdo takim	5.000 Çdo takim
20	**Të gjithë personat që klasifikohen si ambulantë.**	2.500	2.500
21	**Transport Pasagjerësh dhe mallrash subjekte juridike te biznesit të madh.**	20.000	20.000
22	**Transport Pasagjeresh dhe mallrash subjekte persona fizik dhe individe për nevoja të veta.**	3.000	3.000

Niveli i tarifës për familjarët e Nj/Adm Gjinaj, përfshirë fshatrat Cahan, Kishaj, Mujaj është **400** Lekë/vit. Niveli i tarifës për familjarët përfitues të ndihmës ekonomike është **600** Lekë/vit. Niveli i taksës për Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) është **200 lekë** në vit. Niveli i tarifës për bizneset sipas zonave:

Zona "A" 100%

Zona "B" 80%

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim sektorë te tjerë dhe njësitë administrative.

Neni 15

Tarifa e gjelbër

Tarifa në lekë/vit

Nr	Emërtimi i subjektit	2025	2026
1	**Familjarët**	0	200
2	**Shitoret për fruta, perime, ushqimore, bulmetore me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	800	800

	b. mbi 50 m²	1.000	1.000
3	**Shitoret për mish, peshk me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	600	600
	b. mbi 50 m²	700	700
4	**Lokalet bar-bufe, restorante me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	700	700
	b. mbi 50 m²	1.000	1.000
5	**Shitoret e artikujve të përzier dhe industriale me sipërfaqe lokali :**		
	a. deri në 50m²	750	750
	b. mbi 50 m²	1.000	1.000
6	**Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj dhe institucionet social kulturore private.**	3.000	3.000
7	**Njësi shërbimi, riparime, punime artizanale, rrobaqepësi, servise, lavazhe, parkingje, bilardo, fotograf të biznesit të vogël.**	500	500
8	**Njësi shërbimi e riparimi (teneqepunues, zdrukthtari, radio, riparim telefonash, berber,floktore, taksi etj.)**	500	500
9	**Shërbimet e specializuara : Dentist, farmaci, farmaci bujqësore, radiolog, sherbime interneti, ekografist, laborator.**	2.500	2.500
10	**Shërbime të tjera si: Avokat, noter, kancelarie,fotokopje, librari, shtypshkronjë, kafe internet, Njësi transferta parash apo këmbime valutore.**	500	500
11	**Njësi prodhimi (druri, duralumini, parafabrikate ndërtimi, furra buke, ëmbëltore, byrektore etj.)**	600	600
12	**Biznes i vogël që klasifikohet me T.V.Sh.**	2.500	2.500
13	**Të gjithë personat juridikë të biznesit të madh, dhe sh.a –të, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe.**	3.000	3.000
14	**Kompanitë celulare apo të komunikimeve elektronike dhe të lidhura me to**	4.000	4.000
15	**Firmat e ndërtimit dhe të lidhura me to.**	2.500	2.500
16	**Firmat e tregtimit të karburanteve dhe të gazit**	2.500	2.500

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

17	**Subjektet me aktivitet minerar, hidrocentraleve, inerteve (guroret) dhe fabrikat pamvaresisht zones A apo B.**	3.000	3.000
18	**Të gjithë personat që klasifikohen si ambulantë**	300	300
19	**Transporte te licensuara, shpk, biznes i madh**	2.000	2.000

Niveli i tarifës sipas zonave: Zona "A" 100%

Zona "B" 80%

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

Neni 16

Tarifa e ndriçimit

Tarifa në lekë/vit

Nr.	Emërtimi i subjektit	2025	2026
1	Të gjithë subjektet e biznesit të vogël.	2.500	3.000
2	Të gjithë subjektet e biznesit të madh.	4.000	5.000
3	Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.	4.000	6.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

Neni 17

Tarifa të sektorit të urbanistikës dhe planifikimit të territorit për vitin 2026

Tarifat e shqyrtimit të praktikave për leje zhvillimi, ndërtimi, mirëmbajtje, certifikatë përdorimi, akte kontrolli si detyrime që rrjedhin nga Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" me ndyshimet përkatëse, si dhe funksionimit të sistemit elektronik të ***e-lejeve***, janë si në tabelën më poshtë:

Tarifat e shërbimeve të Sektorit të Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit **për vitin 2026**

Nr.	Shërbimi	Vlera e Tarifës në Lekë
1	Tarifë për shqyrtim kërkesë Leje Zhvillimi.	5'000
2	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi të ri për sipërfaqe **më të madhe se 250 m2** që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	10'000
3	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për ndërtim të ri për sipërfaqe **deri 250m2** që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000

4	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues për sipërfaqe **më të madhe se 250 m2** që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	10'000
5	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për shtesë në ndertim ekzistues **për sip.deri 250 m2** që në momentin e dorëzimit të kerkesës per leje.	5'000
6	Tarife për shqyrtim Leje Ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues	10'000
7	Tarifë për shqyrtim kërkese për mirëmbajtje të zakonshme, në momentin e aplikimit.	0
8	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni,që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
9	Tarifë për shqyrtim Leje Ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni që në momentin e dorëzimit të kërkesës për leje.	5'000
10	Tarifë për shqyrtim **Deklaratë paraprake punimesh** që në momentin e dorëzimit të kërkesës për pajisje me deklarate.	0
11	Tarifë për shqyrtim Leje për shtyrjen e afatit të lejes	5'000
12	Tarifë për Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit.	0
13	Tarifë për shqyrtim Leje për ndryshimin e funksionit/aktiviteteve.	5'000
14	Akt kontroll karabina,sistemim I jashtëm për objekte mbi 3 kate	1'500 për akt
15	Tarifë për shkresë përcjellëse (Aluizni, ZRPP, AKKP etj.).	0
16	Shqyrtim për pajisje me çertifikate përdorimi.	5'000
17	Tarifë për çertifikatë përdorimi për objekte industriale, për volumin e objektit të ndërtuar.	50 lekë/m3
18	Tarifë për çertifikatë përdorimi për shtëpi banimi dhe ndërtime apo ambiente shërbimi për volumin e objektit të ndërtuar (jo industrial).	39 lekë/m3

Ngarkohet Sektori i Urbanistikës për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e këtyre tarifave dhe të ardhurat arkëtohen nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore pranë Bashkisë Has.

Neni 18

Tarifa e Reklamës

Tarifa në lekë/vit

Nr.	Emërtimi i Subjektit	2026
1	Të gjithë personat juridikë dhe Institucionet shtetërore, administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive etj.	5.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

Neni 19

Tarifa të shërbimit veteriner

Tarifa është detyrim fiks që aplikohet nga shërbimi veterinar për të gjithë kategoritë e subjekteve apo individeve që kanë aktivitet me thertoren me pikën e therjes apo tregun e gjësë së gjallë.

	Kategoritë e aktivitetit të kontrollit	**Kontrolli**	**Tarifa për çdo bagëti të therur**
1	Kontrolli i mishit dhe paisja me raport veterinar për kre për bagëti **të Trasha**	Kontrolli mbi gjendjen e kafshës para, gjatë dhe pas therjes. Vulosja dhe plotësimi i doumentacionit.	**500** Lekë (për çdo kre)
2	Kontrolli i mishit dhe paisja me raport veterinar për kre për bagëti **të Imëta**	Kontrolli mbi gjendjen e kafshës para, gjatë dhe pas therjes. Vulosja dhe plotësimi i dokumentacionit.	**200** Lekë (për çdo kre)

Struktura e ngarkuar per vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Has.

Neni 20

Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti

Tarifat e licencimit të veprimtarive të transportit për vitin 2026.

Nr.	Tarifat e licencimit të transportit të udhëtarëve	Njësia	Tarifa
1.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/5 vjet	40,000
2.	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/vit	5,000
3.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rreth qytetëse	Lekë/5 vjet	20,000
4.	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rreth qytetëse	Lekë/mjet/vit	1,500
5	Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet	15,000
6.	Licencë për agjenci ndërkombëtare udhëtarësh	Lekë/5 vjet	40,000
7.	Licencë për transport udhëtarësh me taksi	Lekë/mjet/5 vjet	20,000

8.	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	Lekë/5 vjet	50,000
9	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit		
9.1	për mjete deri 2 ton	Lekë/mjet/1vjeçar	3,000
9.2	për mjete 2 deri 5 ton	Lekë/mjet/1vjeçar	5,000
9.3	Për mjete mbi 5 ton	Lekë/mjet/1vjeçar	6,000
10	çertifikatë për tërheqës	Për tërheqës/1 vjeçar	5,000
11	çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	Për mjet/1 vjeçar	3,000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Sektori i Taksave dhe Tarifave.

Neni 21

Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë

	Tarifë parkimi automjete	Njësia	Tarifa
A	Parkim me pagesë (në sheshe dhe zona të miratuara)	Lekë/orë/mjet	50
B	Automjete (abonim vjetor për parkim në zonat e miratuara)	Lekë/vit/mjet	30,000

Neni 22

Tarifë për ujin e pishëm

Fshatrat	Tarifa në vitin 2023	Tarifa për vitin 2024
Golaj	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset
Nikoliq	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset
Fajza	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset	**30** lekë/m3 familjarët dhe **60** lekë/m3 bizneset

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Neni 23

Tarifa për ujin e vaditjes

Tarifa për ujin e vaditjes: 100 lekë /ora (për sasinë 10 litra për sekondë).

Neni 24

Tarifa për drutë e zjarrit

Tarifa për drutë e zjarrit: 600lekë/m3

Neni 25

Dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Has, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Tabelë. Dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj për vitin 2026.

	Tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.	Njësia	Tarifa
1	Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante	Lekë/ 5vjet	1.000.000
2	Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë	Lekë	100.000

Tarifa sipas pikes 1 e tabeles së mësipërme mund të ndahet në këste vjetore me vlerë prej 200.000 lekë në vit, por në çdo rast liçenca duhet të lëshohet 5 vjeçare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Sektori I Taksave dhe Tarifave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Neni 26

Tarifa e zënies së Hapësirave Publike

2.13. Niveli Tregues i Tarifës së Zënies së Hapësirës Publike

Nr.	Kategoria e tarifes	Qyteti Has
1.	Për zënie hapësirës publike për tregti (vendosje tavolinash).	60 lekë/m²/muaj

2	Merkatoja (Tregu i lirë publik)	120lekë/m²
2.	Për zënie hapësirës publike për tregti (mallra jashtë vendit të tregtimit).	60 lekë/m²/muaj
3.	Për spektakle, panaire të ndryshme, aktivitete kulturore, aktivitete sportive, promocion biznesi, etj.	200 lekë/m²/muaj
4.	Për zënie sipërfaqe me platforma ndërtimore, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativ etj, sipërfaqe të zëna me antena televizive dhe telefoni, kabina elektrike, shtyllat e transmetimit të energjisë elektrike, nënstacione elektrike, fusha sportive, varreza makinash, pishina, çadra fushimi, rulota etj. të ngjashme me to.	60 lekë/m²/muaj
5.	Per sheshe grumbullim, perpunim minerali, jashte zones se miratuar ne Lejen Minerare	100 lekë/m²/muaj
6.	Sheshe grumbullim, perpunim dhe prodhim inertesh, jashte zones se miratuar ne Lejen e Ndertimit	60 lekë/m²/muaj
7.	Zënia e hapësirës publike ditore për qëllime biznesi: ekspozim – promocion i produkteve, i shërbimeve, aktivitete tregtare, etj.	200 lekë/m2/ditë
8.	Per ushtrim aktiviteti, loja elektronike per femije (cirk, kënd lojrash) etj.	100 lekë/m²/muaj

Përjashtime: Përjashtohen nga tarifa e përkohshme aktivitetet e organizuara apo në partneritet me Bashkinë Has për promovimin e produktit territorial.

Taksapaguesit përfitojnë kushte lehtësuese kur lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë përfitojnë reduktimin në masën 10 % të vlerës së detyrimit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Sektori i Taksave dhe Tarifave. Sektori I Urbanistikës ngarkohet për hartimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e sipërfaqeve/ hartave të parcelave objekt i kësaj takse si dhe publikimin e tyre. Sektori Juridike ngarkohet për përgatitjen e kontratës-tip për dhenien e sipërfaqeve në zënien e hapësirës publike.

Neni 27

Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim.

Baza ligjore: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar; VKM nr. 992, datë 09.12.2015 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" (pikat 1 dhe 2); ligji nr. 9232, datë 13.05.2015; ligji nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 19, pika 1. Sipas përcaktimeve ligjore, pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i

lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë, pajisjet dhe linjat e prodhimit. Të ardhurat nga qiratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve. Sektori Juridik dhe Sektori i Financës kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga Sektori Juridik.

- Kontrata e qerasë me Sigurimet Shoqërore Has: 30.000 Lekë /muaj.

Neni 28

Lehtësime dhe Përjashtime nga Taksat Vendore

1. Për subjekte të reja të biznesit gjatë vitit nga gra, vajza dhe të rinj nën moshën 25 vjeç përfitojnë ulje të detyrimeve vendore në masën tridhjetë për qind (30%).
2. Afati për shlyerjen e detyrimit vjetor për taksat e tarifat vendore për subjektet e biznesit është data 30.06.2023, pas këtij afati aplikohet gjoba/ kamatevonesa.
3. Për teritoret ku nuk kryhet shërbimi, të specifikohet nga sektori përkatës dhe të mos aplikohet tarife pastrimi, ndriçimi apo gjelbërimi.
4. Të gjithë emigrantët që kthehen nga emigracioni dhe hapin biznese të reja do të përjashtohen nga taksat dhe tarifat vendore për 3-vitet e para.
5. Ulja në masën pesë për qind (5%) për çdo subjekt kur ai likujdon të gjitha detyrimet per taksat dhe tarifat vendore në një këst, brenda datës 20 Prill 2025.

KREU 3

GJOBAT POLICIA BASHKIAKE

Llojet dhe nivelet e gjobave do të zbatohen nga inspektorët e kontrollit të territorit dhe policia Bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundravajtjeve administrative. Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.10279 datë 20/05/2010. "Për kundërvajtjet administrative neni 6 pika b dhe neni 10,

Niveli i gjobave për shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative do të jetë:

Neni 29

Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtar pa licensë, autorizim apo leje përkatëse

Mospasja me licensë, autorizim apo certifikatë përkatëse transporti:

- Motokarro 1.000 lekë
- Transport udhëtarësh taksi (1+4) 1.000 lekë
- Transport udhëtarësh taksi (1+8) 2.000 lekë
- Mjete të tonazhit të lartë 5.000 lekë

Hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë 10.000 lekë – 15.000 lekë

Mospasja me leje për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit: 10.000 – 20.000 lekë

Mospasja me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit 5.000 – 10.000 lekë

Mospasja me leje për zënie të hapësirës publike

- Ekspozim malli 5.000 – 10.000 lekë
- Veprimtari që zhvillohen në hapësirat publike 5.000 – 10.000 lekë

Mosmarrja e masave për izolimin e ambientit për daljen e zhurmave nga ambientet e lokaleve 10.000 lekë

Neni 30

Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore

a. Dëmtim rruge 5.000 – 10.000 lekë

b. Carje rruge 10.000 – 20.000 lekë

c. Bllokim rruge 5.000 – 10.000 lekë

d. Dëmtim bordure 5.000 – 10.000 lekë

e. Dëmtim trotuari 5.000 – 10.000 lekë

f. Carje trotuari 10.000 – 20.000 lekë

g. Bllokim trotuari 5.0 – 10.000 lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Neni 31

Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor

1. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit 10.000 – 20.000 lekë
2. Dëmtim i ndriçuesve 10.000 – 15.000 lekë
3. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montim reklamash, kapjen e kabllove, etj. 3.000 – 5.000 lekë

Neni 32

Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit

- Lidhje e pa miratuar në tubacion: 5.000 – 10.000 lekë

- Dëmtim i pusetave: 10.000 – 20.000 lekë
- Dëmtim i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje:5.000 – 10.000 lekë

KRYETAR

Miftar Dauti



Përgjegjësi i Sektorit

Taksave dhe Tarifave

Fatmira Qema

